



Pranuar / Dorezuar Punëhënë/Prudato Received/Delivered	30.12.2021	viti god year	1
Organ /Njësia Organ /Jedinica Org /Unit	Nr Prot Nr Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPM/KJK	6443/2021		1/4



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO**

**A.nr.1182/2021**

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Eshref Shaban-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Arben Mehmeti-anëtarë dhe Avdyll Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, bazuar në Aktgjykimin A.nr.2134/2019 të datës 09.11.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.358/2019 të datës 26.06.2019 të parashtruar nga ankuesi

me adresë fshati "Ramnishtë", rruga "Azem Qeli" në Komunën e Vitisë, kundër Vendimit më Nr.10/2019 të datës 30.05.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë së Punëve të Jashtme, në çështjen juridike "kërkesë nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 29.12.2021, mori këtë:

**V E N D I M**

Shpallet jo kompetent, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës për të vendosur lidhur me ankesën me numër A.nr.358/2019 të datës 26.06.2019 e parashtruar nga ankuesi

**A r s y e t i m**

Ankuesi, në vitin 2010 ka dhënë dorëheqje nga shërbimi civil i Ministrisë së Punëve të Jashtme, ku për rastin e dorëheqjes Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka vendosur sipas Vendimit A 02/173/2012 të datës 27.07.2012. Ankuesi pas konkursit të datës 12.03.2019 të shpallur nga Ministria e Punëve të Jashtme për pozitën "Zyrtar i Misionit Diplomatik-15 pozita", më datë 26.03.2019 ka parashtruar kërkesë ne Nr. Prot:924 teka Zyra e Personelit e Ministrisë së Punëve të Jashtme që punësohet në shërbimin civil përmes pjesëmarrjes në procedurat e jashtëzakonshme, pastaj më datë 02.05.2019 ka parashtruar ankesë me Nr. prot:1186 në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë së Punëve të Jashtme.



Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Ministrisë së Punëve të Jashtme me datë 30.05.2019 ka nxjerr Vendim me Nr. 10/2019 me të cilin ka refuzuar ankesën e ankuesit duke theksuar se në bazë të konkursit të shpallur të gjitha kandidatët aplikojnë për këtë pozitë pa përjashtime dhe duhet që dokumentet të sillen fizikisht në Zyrën e Personelit të MPJ-së ose me postë.

Ankuesi, kundër Vendimit me Nr. 10/2019 të datës 30.05.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave Ministrisë së Punëve të Jashtme, më datë 26.06.2019 ka parashtruar ankesë me numër protokoll 2858/2019 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 27.06.2019 ka kërkuar prova në Ministria e Punëve të Jashtme lidhur me ankesën e ankuesit. Ministria e Punëve të Jashtme më datë 22.08.2019 ka dërguar përgjigje në ankesë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nga muaji janar i vitit 2019 deri më datë 08.10.2020 ka qenë jo funksional dhe nuk ka vendosur për ankesën e ankuesit, ndërsa më datë 13.08.2019, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka njoftuar ankuesin për arsyet e mos shqyrtimit të ankesës duke udhëzuar që mund të ndiqni procedurat e mëtejme dhe se në pajtim me Ligjin për Konfliktin Administrativ mund të filloni procedurën gjyqësore pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative.

Ankuesi ka ndjekur procedurat e tjera duke iniciuar konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative. Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative më datë 25.05.2021 ka nxjerr Aktgjykim A.nr.2134/2019 me të cilin ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit duke anuluar njoftimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të datës 13.08.2019 dhe duke e detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës që brenda 30 ditësh të vendos për ankesën e datës 26.06.2019.

**Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka administruar këto prova:** Ankesën me numër protokoll 2858/2019 të datës 26.06.2019 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me Nr. 10/2019 të datës 30.05.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave Ministrisë së Punëve të Jashtme; Konkursin e datës 12.03.2019 të shpallur nga Ministria e Punëve të Jashtme për pozitën "Zyrtar i Misionit Diplomatik-15 pozita"; Ankesën e datës 02.05.2019 të parashtruar nga ankuesi në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë së Punëve të Jashtme; Kërkesën e datës 26.03.2019 e ankuesit e parashtruar pranë Zyrës së Personelit të Ministrisë së Punëve të Jashtme; Vendimin A 02/173/2012 të datës 27.07.2012 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 27.06.2019 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Përgjigjen në ankesë e datës 22.08.2019; Njoftimin e datës 13.08.2019 dhe Aktgjykimin A.nr.2134/2019 të datës 09.11.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, duke i shqyrtuar të gjitha provat e lëndës të dërguar nga palët, ka konstatuar se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën e ankuesit

*sepse:*

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, gjatë shqyrtimit të provave të lëndës dhe pretendimeve ankimore të ankuesit i cili pretendon që meqenëse ka dhënë dorëheqje nga shërbimi civil i Ministrisë së Punëve të Jashtme duhet që të punësohet në shërbimin civil përmes pjesëmarrjes në procedurat e jashtëzakonshme, ka konstatuar që ankuesi ka qenë i punësuar në shërbimin civil të Republikës së Kosovës, respektivisht në Ministrinë e Punëve të Jashtme, mirëpo në vitin 2010 ka dhënë dorëheqje nga shërbimi civil me ka është vendosur edhe nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës sipas Vendimit me numër A 02/173/2012 të datës 27.07.2012.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se ankuesi në momentin që ka dhënë dorëheqje nga shërbimi civil e ka humbur statusin e nëpunësit civil sipas legjislacionit për shërbimin civil të Republikës së Kosovës, kështu që ankuesi në ankesën e datës 26.06.2019 të parashtruar pranë Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk ka kontestuar procedurën e rekrutimit për pozitën "Zyrtar i Misionit Disiplomatik-15 pozita", të shpallur nga Ministria e Punëve të Jashtme sipas konkursit të datës 12.03.2019, por i njëjti përmes kësaj ankese ka kërkuar që të punësohet me një procedurë të jashtëzakonshme, pa aplikuar në këtë pozitë, kështu që Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se meqë ankuesi ka dhënë dorëheqje nga shërbimi civil, i njëjti për t'u kthyer në shërbim civil duhet kthehet nëpërmjet procedurave të rekrutimit të përcaktuara me legjislacionin për shërbimin civil të Republikës së Kosovës.

Bazuar në fushëveprimtarinë e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, konstatohet se njëjti është kompetent të shqyrtoj vetëm ankesat e nëpunësve civilë dhe kandidatëve për pranim në shërbimin civil ashtu siç është përcaktuar me nenin 6 paragrafin 1 të Ligjit nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ku përcaktohet se: *"Për mbikëqyrjen e zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil, Këshilli ka këto funksione themelore: 1.1. shqyrton dhe merr vendime për ankesat e nëpunësve civil dhe kandidatëve për pranim në shërbimin civil"*, andaj bazuar në këtë, meqenëse ankuesi nuk ka statusin e nëpunësit civil po ashtu nuk ka asnjë dëshmi që i njëjti ka aplikuar apo përmes ankesës konteston procedurën e rekrutimit për pozitën "Zyrtar i Misionit Disiplomatik-15 pozita", të shpallur nga Ministria e Punëve të Jashtme, atëherë në kuptim të nenit 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe nenit 18 paragrafi 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, shpallet jo kompetent për të vendosur për ankesën e ankuesit.


Duke marr parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe provat e bashkëngjitura në lëndë, Kolegji për shqyrtimin e ankesave duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.



**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda me numër A.nr.1182/2021.

**Avdyl BEKTESHI**  
Procesmbajtës



**Eshref SHABANI**  
Kryetar i Kolegjit

**Vendimi i dërgohet**

- Ankuesit,
- Znj. *Gjyqtare në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative;*
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës;
- Arkivat të KPMSHCK.

